



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Member of International Helsinki Federation for Human Rights

Tiranë, më 15 Korrik 2007

Sulm selektiv me synime politike

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), edhe më parë ka reaguar publikisht ndaj veprimeve arbitrare të organeve përkatëse shtetërore që në emër të zbatimit të ligjit kanë synuar t'i bëjnë presion medias së lirë.

Në këtë vështrim, tentativat për të zbehur dhe mbytur zërin e fuqishëm dhe kritik të Televizionit "Top Channel" u konkretizuan me një gjobë drastike që edhe pse jo transparente është e kuptueshme për të gjithë.

KSHH ka parasysh faktin se zbatimi korrekt i ligjit duhet të gjallërojë dhe jo të mbysë zërin kritik të medias. Në zbatimin e tij, përparësi duhet të ketë parandalimi i shkeljes dhe jo shpërdorimi në mbrojtje të interesave të caktuara.

Trajtimi selektiv, me elementë të dukshëm politikë, bie ndesh me parimin kushtetues të barazisë para ligjit dhe të mosdiskriminimit. "Top Channel" dhe televizione të tjera, në zbatim të misionit të tyre, herë pas here kanë evidentuar dhe fshikulluar rastet e shumta të korrupsionit dhe të nepotizmit, të abuzimeve në administratës publike dhe të mungesës së transparencës.

KSHH konsideron të ligjshme dhe me ndikim të dukshëm pozitiv qëndrimet e medias së shkruar dhe asaj elektronike në drejtim të informimit të publikut të gjerë me qëllim ndërgjegjësimin dhe parandalimin e fenomeneve negative që pengojnë zbatimin e reformave demokratike dhe në të njëjtën kohë çënojnë imazhin e vendit tonë.

Është pikërisht kjo arsyeja që KSHH i konsideron të drejta reagimet e shoqatave të gazetarëve dhe mediave vizive në mbrojtje të fjalës së lirë.

"Në sistemin demokratik, - thuhet në një nga vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, - veprimet dhe mosveprimet e qeverisë duhet të jenë objekt i një kontrolli skrupoloz jo vetëm nga legjislativi dhe gjykatat, por edhe nga shtypi dhe opinionin publik. Si pasojë e pozitës dominuese që ka qeveria, ajo duhet të jetë e matur në përdorimin e sanksioneve penalizuese".

Vendime të tilla që mbështeten në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, janë jo vetëm orientuese, por edhe detyruese për vendin tonë si anëtar i Këshillit të Evropës i cili synon integrimin në familjen evropiane.

KSHH i sygjeron Ministrin të Financave dhe Kryeministrin të Republikës së Shqipërisë, që të urdhërojnë shqyrtimin e masës së marrë ndaj Televizionit "Top Channel".